



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:277493

Datë: 04.11.2020

Numri i dokumentit: 01244956

**P.nr.1068/19**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PEJE – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, sipas Gjyqtarit Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e praktikantes ligjore Edita Ferati, në lëndën penale kundër të pandehurit K. N. nga ....., i akuzuar për veprë penale, *vjedhje e pyllit*, parashikuar nga neni 349 par.3 nen par. 3.1 të KPRK-së duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2330/19 të datës 23.11.2019, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me 20.10.2020, në praninë e Prokurores së Shtetit Suada Hamza dhe te pandehurit K. N., me dt. 21.10.2020 mori dhe publikisht shpalli, dhe te njëjtën ditë përpilo, ndërsa me dt. 04.11.2020 mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I akuzuari,**

**K. N.**, i lindur me dt.28.01.1986 ne fsh. ...., K. ...., ku edhe jeton por gjatë sezones se dimrit me banim ne fsh. ...., K. ...., i biri i V. N. dhe nënës D., e gjinisë L., ka te kryer gjashtë klase te shkollës fillore, i pa martuar, i pa punë, me nr. personal ....., me nr. tel ....., shqiptar, shtetas i Rep. Së Kosovës, mbrohet ne liri.

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Për shkak se:**

Në fund të muajit shtator 2019 ne fsh. ...., K. .... përkatësisht ne parkun e mbrojtur “.....” e cila është nen administrimin e DAPK-së, pret trunqje ne atë mënyrë qe i njëjti pasi fillimisht ne vendin dhe kohen e lartcekur pret dy trunqje te llojit te breut me vëllim prej 1.39 m3 dhe te njëjtat i ngarkon ne kamionin e tij dhe me dt. 12.10.2019 niset ne drejtim te Pejës, për tu hetuar me pas nga Policia e Kosovës, te cilët bëjnë sekuestrimin e masës drusore dhe automjetit,

-Me çka ka kryer veprën penale, *vjedhje e pyllit*, parashikuar nga neni 349 par.3 nen par. 3.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata komfor nenit 2, 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 21,38,39 par.1 pika 1.2 dhe 1.3, 46 par.1 nen par. 1.1, 47, 48, 49, 69, dhe nenit 349 par.3 nen par. 3.1 të KPRK-së dhe

neneve 245,246, 248 par.1 dhe 4, 359, 360, 361, 362, 365, 366, 370, 453 par.4 dhe 463 par.2 te KPPRK-se, të pandehurin e gjykon me:

### DENIM ME KUSHT

-Ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj burgim. Dënimi me burg fare nuk ka për tu ekzekutuar, nëse i pandehuri, ne afat prej 1(një) viti, nuk kryen vepër te re penale. Ndaj të akuzuarit K. N., në kuptim të nenit 62 par.1 dhe par.2 nën par. 2.6 të KPRK-së, shqiptohet edhe:

#### Dënim Plotësues:

- Konfiskohet masa e sekuestruar prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) cope shtafne te breut.
  - Urdhërohet Agjencioni për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar qe duke u thirrur ne nr. e rastit 2019-DA-2047 te administroje me sortimentet pyjore të sekuestruara komfor Ligjit mbi Administrimin e Pasurisë dhe te beje shitjen ku mjetet e fituara nga shitja te derdhen ne buxhetin e Republikës së Kosovës, e këtë pasi që aktgjykimi ta merr formën e prerë
- Detyrohet i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve te procedurës penale, te paguajë shumën prej 30 (tridhjetë) euro, ne emër te paushallit gjyqësor shumen prej 20 (njëzet) euro, ndërsa ne emër te viktimave te krimit shumen prej 30 (tridhjetë) euro.
- Pala e dëmtuar, DAPK “.....” për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.
- E te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzën PP.II.nr.2330/19 të dates 23.11.2019, ndaj te pandehurit K. N., për vepër penale, vjedhje e pyllit, parashikuar nga neni 349 par.3 nen par. 3.1 të KPRK-së duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2330/19 të datës 23.11.2019.

Gjykata, mbajti shqyrtimin fillestar, me datë 20.10.2020, ne praninë e Prokurores së Shtetit Suada Hamza dhe të pandehurit K. N.nga ...., në të cilën seancë i pandehuri pasi që u njoftua me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij dhe pasi që Prokurorja e Shtetit lexoi aktakuzën, i akuzuari deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet. Shprehi keqardhjen e tij dhe deklaroi se me nuk do përsëris vepra te tilla.

Pas deklaramit se i pandehuri pranoi fajësinë, mendimit të prokurores e cila nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Gjykata konstatoi se i pandehuri e pranoi fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion. I pandehuri K. N. është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1, të KPPRK-se, janë përmbushur. Andaj, gjykata aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe duke u ndërlidhur me atë se, ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 248 par 4, të KPPRK-së, atëherë, në këtë çështje penale, nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklaramit të pandehurit se e pranon fajësinë ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë: pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: procesverbali mbi sekuestrimin e sortimeve pyjore 000468 në të cilin ndër të tjera ceket se tek i pandehuri janë sekuestruar disa shtafne të prera në parkun kombëtar “.....”, raporti i policit A. V. #9765 e dt. 12.10.2019 në të cilin ndër të tjera ceket se tek i pandehuri janë gjetur këto drunjë, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve në të cilin ndër të tjera ceket se tek i njëjti është sekuestruar kamioni i lartcekur, raporti i DAPK-së i dt. 15.10.2019 në të cilin ndër të tjera ceket se kjo masë drunore është prerë në ngastrën private, kopja e planit, certifikata e pronësisë me nr. 00003-46 dhe fotografitë e vendit të ngjarjes ku shihen trungjet e prera rrjedh se në veprimet e të pandehurit K. N., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, *vjedhje e pyllit*, parashikuar nga neni 349 par.3 nën par. 3.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë, gjykata ka gjetur se, të pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer. Gjatë procedurës penale, nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti e bëri pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe ndikim, shprehi keqardhjen e tij për atë çfarë ka ndodhur dhe u betua që me nuk do të ndodhë. Rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 69 të KPRK-se të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka arritur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Vendimin mbi dënimin plotësues Gjykata e mori në përputhje me nenin 284 par.1 dhe 2 e lidhur me nenin 6 të KPPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1, 2 pika 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale penale ne shume prej 30 (tridhjetë) euro dhe në formë të paushallit gjyqësor shumën prej 20 (njëzet) euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Vendimi për kompensimin e viktimave te krimit, ne shumen prej 30 (tridhjetë) euro, gjykata e mori në përputhje me nenin 39, par.1,2,3, nën par. 3.1, të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit, duke e obliguar të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar qe kërkesën pasurore juridike ta realizoj ne kontest civil u morr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr.1068/19 i dt. 21.10.2020**

**Praktikante,**

\_\_\_\_\_  
**Edita Ferati**

**Gjyqtari Gjykues,**

\_\_\_\_\_  
**Dr.sc. Murat Hulaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.